2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- | | |
|--|---|
| 23. Njoftimi i Fituesit | 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese. |
| 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës | <div>1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.</div> <div>2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.</div> |

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

-
- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
 - b) garanci bankare;
 - c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia pagese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: _LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial.....

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KULTURËS DHE SPORTIT

Transport per Aktivitetet e Qendres Kulturore "P.Gaci".

Çmimi "P.Gaci" - 4 rruge transporti për jurine pjesmarrëse 5 persona, nga Tirane drejt Shkodrës ne nje dite qendrim dhe anasjelltas Ardhja e tyre për në Shkodër dhe kthimi I tyre nga Shkodra per ne Tirane në fund të aktivitetit. Kthimi mund te jete me dite ndermjet.

Pjesmarrje ne aktivitete artistike - 1 rruge transporti trupe artistike deri ne 50 persona ne Itinerarin Shkoder-Elbasan—Shkoder. Kthimi brenda dites.

Pjesemarrje ne aktivitet artistik Prishtine

1 rrugë transporti trupe artistike deri ne 50 persona ne itinerarin Shkoder-Prishtine-Shkoder.Kthimi mund te jete me dite ndermjet sipas kerkesave te aktivitetit.

Pjesemarrje ne aktivite artistike Gjakove- 1 rrugë transporti trupe artistike deri ne 35 persona ne itinerarin Shkoder-Gjakove-Shkoder me 2 nete qendrimi ne Gjakove sipas kerkesave te aktivitetit.

Pjesmarrje ne aktivite artistike Peje - 1 rrugë transporti trupe artistike deri ne 55 persona ne itinerarin Shkoder-Peje-Shkoder me 2 nete qendrim ne Peje,sipas kerkesave te aktivitetit.

Pjesmarrje ne aktivite me Orkestren Frymore (Tivat)

1 rrugë transporti i Orkestres frymore Shkoder, deri ne 50 persona me 1 nate qendrim ne Tivat.

Ahengu Shkodran (Ulqin) 1 rrugë transporti trupe artistike deri ne 40 persona ne itinerarin Shkoder-Ulqin-Shkoder, brenda dites.

- Transport per Galerine e Arteve

“Salloni i vjeshtës ” 2025 - 2 rrugë vajtje ardhje transporti për dy kuratorët pjesëmarrës,nga Tirane drejt Shkodrës ne nje dite dhe 2 rrugë transporti për jurine pjesëmarrëse,nga Tirana drejt Shkodrës ne nje dite dhe anasjelltas 2 rrugë transporti I veprave te artit , per vepra qe grumbullohen ne Tirane, ardhja e tyre për në Shkodër dhe kthimi I tyre nga Shkodra per ne Tirane në fund të aktivitetit.

Ekspozite e lire 2025

2 rrugë transporti për 1 kurator pjesëmarrës,nga Tirana drejt Shkodrës ne nje dite dhe kthimi per dy kuratore nga Shkodra per Tirane nje dite tjete 2 rrugë tranporti veprash ardhje kthim, nga destinacioni x per ne Shkoder

Personazh i ftuar 2025

a) 2 rrugë transport kur artisti vjen te shoqeroje veprat nga Tirana per ne Shkoder ne nje dite dhe kthimi e tij nga Shkodra per ne Tirane nje dite tjeter.

b) Bartja e veprave nga 4 punetore per marrjen dhe kthimin Tranporti te kryhet me furgon mallrash me lartesi 2m,gjeresi 2m dhe thellesi 3m per kater rrugë vajtje ardhje.

Cmimi “Idromeno”

2 rrugë vajtje ardhje- transporti për veprat dhe kuratorin pjesëmarrës,nga Tirana drejt Shkodrës ne nje dite dhe kthimi

2 rrugë transporti për jurine pjesëmarrëse,nga Tirana drejt Shkodrës ne nje dite dhe kthimi

Programet e edukimit2025

1 rrugë transporti nga Tirana per ne Shkoder dhe 1 rrugë kthimi nga Shkodra ne Tirane, nje i ftuar.

- Transport Festivali mbare kombetar i humorit

- Transport per Festivalin mbarekombetar te humorit per tete persona 2 rrugë vajtje- ardhje Tirane – Shkoder dhe anasjelltas , - 20 persona.

- Transport per Festivalin mbarekombetar te humorit 1 rrugë vajtje e ardhje Shkup- Shkoder-Shkup 20 persona.

- Transport per Festivalin mbarekombetar te humorit nje rrugë vajtje e ardhje Prizren- Shkoder-Prizren 20 persona.

- Transport per Festivalin mbarekombetar te humorit per nje rrugë vajtje e ardhje Vlore- Shkoder-Vlore 20 persona.

- Transport per Festivalin mbarekombetar te humorit nje rrugë vajtje e ardhje Ulqin- Shkoder-Ulqin 20 persona

- Transport per Festivalin mbarekombetar te humorit nje rruge vajtje e ardhje Korce- Shkoder- Korce 20 persona.

- Transport per aktivitete te Teatrit

Teatri Migjeni do te bashkepunoje me teatro te tjera te prezantoje veprat artistike ne qytete te tjera te Shqiperise, Kosoves dhe Shkup etj si dhe te ftoje trupa artistike te qyteteve te tjera qe do te shfaqin veprat e tyre ne Teatrin Migjeni si me poshte,

- Transport trupa e aktoreve dhe skenografi te Teatrit Migjeni ne Korce, vajtje ardhje 1 rruge, rreth 20 persona dhe transport skenografie.

- Transport e trupes artistike te teatrit Prishtines ne Shkoder, 1 rruge, ardhje dhe vajtje, 20 persona.

- Transport trupa e aktoreve dhe kengetareve te Teatrit Migjeni ne Prizren , vajtje ardhje 1 rruge, rreth 15 persona.

- Transport trupa e aktoreve dhe kengetareve te Teatrit Migjeni ne Tirane, vajtje ardhje 4 rruge, rreth 15 persona dhe transport skenografie.

Transport per aktivitete te Teatrit

Teatri Migjeni do te bashkepunoje me teatro te tjera te prezantoje veprat artistike ne qytete te ndryshme , Transport e skenografise se shfaqes “Vizita” ne Teatrin “Koreia”, Lecce , Italy

Mberritja ne Lecce : Date 11.05.2025 , ora 12;00

Kthimi nga Lecce ,Italy për në Shkoder , Shqiperi , Data 13.05.2025

Kamioni duhe të jetë me permasa :

6.2 m gjatesi

2.4 m gjeresi

2.4 m lartesi

Kapacitet 3.5 ton

Transport e skenografise se shfaqes “Vizita” ne Teatrin “Fontana”, Milano , Itali

Mberritja ne Milano : Date 3.06.2025 , ora 12;00

Kthimi nga Milano ,Italy për në Shkoder , Shqiperi , Data 10.06.2025

Kamioni duhe të jetë me permasa :

6.2 m gjatesi

2.4 m gjeresi

2.4 m lartesi

Kapacitet 3.5 ton

DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, RINISË, STREHIMIT, SHËNDETIT PUBLIK

“Transport – Mbështetja e Trupës Muzikore të Personave me aftësi ndryshe“

Banda muzikore me rastin e 20 vjetorit të themelimit do të marrë pjesë në Festivalin në Norvegji.

Operatori ekonomik duhet të sigurojë një autobus për transportin për 35 persona, anëtarë të Bandës Muzikore PAN, kujdestarë, mësues dhe staf i organizatës The Door.

Destinacioni:

- Nisja Shkodër – Aeroportin e Rinasit vajtje dt: 20.05.2025 në ora 06.30 e mëngjesit, pranë shkollës Dëshmorët e Prishtinës.

- Kthimi Rinas – Shkodër dt: 27.05.2025 në ora 12:00 e drekës.
- Tip Automjeti: Autobuz me kushte komode për transportin e fëmijëve me AK dhe për instrumentat muzikore, me kapacitet jo më pak se 35 vënde.
- Sediljet të jenë të rehatshme dhe të pajisura me rripa sigurimi.
- Autobuzi të jetë me ajër të kondicionuar, fikse zjarri.
- Drejtuesi i automjetit përgjigjet për gjendjen e rregullt teknike të automjetit.

Dokumentat shoqëruese të mjetit:

- Leje qarkullimi
- Mjeti i Transportit duhet të disponojë dokumentacionin ligjor.
- Çertifikatën e kontrollit teknik
- Policën e sigurimit të detyruar të mjetit
- Lejen e transportit për të transportuar udhëtarët brënda vendit.
- Mjeti duhet të disponojë dokumentacionin ligjor.

Nr	Përshkrimi
1.	Transport - “Mbështetja e Trupës Muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe” Nisja Shkodër – Aeroportin e Rinasit dt: 20.05.2025 në ora 06.30 e mëngjesit Kthimi Rinas - Shkodër, dt: 27.05.2025 në ora 12:00 e drekës

DREJTORIA E MJEDISIT DHE ENERGJISE SE RINOVUESHME

Shërbim transporti në funksion të projektit “Building Smart Forest” Shkodër-Bari-Shkodër

- Mjeti i Transportit duhet të disponojë dokumentacionin ligjor.
- Të sigurojë Transportin për 25 persona, anëtarë të shërbimit zjarfikës të bashkisë Shkoder dhe stafit të projektit.

Nisja do të bëhet pranë Bashkisë Shkodër në orët e para të mëngjesit . Automjeti do jetë në dispozicion zjarrefikese, të Bashkisë Shkoder, të cilët do të marrin pjesë në trajnimin e përbashkët me zjarrefikësit e Malit të Zi (Bashkia Tivar).

Kthimi për në Shkoder do të bëhet ditën e nesërme në një orar i cili do të vendoset sipas agjendës së programit të trajnimit.

- Tip Automjeti: Autobuz/Furgon me kushte komode Sediljet të jenë të rehatshme dhe të pajisura me rripa sigurimi.
- Automjeti të jetë me ajër të kondicionuar, fikse zjarri.
- Drejtuesi i automjetit përgjigjet për gjendjen e rregullt teknike të automjetit.
- Dokumentat shoqëruese të mjetit:
 - Leje qarkullimi
 - Çertifikatën e kontrollit teknik
 - Policën e sigurimit të detyruar të mjetit
 - Lejen e transportit për të transportuar udhëtarët jashtë vendit.

- Mjeti duhet të disponojë dokumentacionin ligjor.

Nr	Përshkrimi
1.	- Numri i personave që do transportohen - 25 (njëzet e pesë) - Itinerari i udhëtimit Shkoder-Bar-Shkoder (tivar) Montenegro. - Periudha kohore brenda të cilës do të kryhet udhëtimi 15 mars – 30 prill. - (udhëtimi do kryhet një ditë vajtje dhe një ditë ardhje, datat do caktohen në - varsi të trajnimit) dhe operatori fitues do njoftohet në momentin e lidhjes së - kontratës për datat e sakta të udhëtimit. - Mjeti duhet të ketë ajër të kondicionuar - Mjeti duhet të ketë minimu 25 ulëse.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Afatet e ekzekutimit:

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KULTURES DHE SPORTIT – vlera e fondit limit është 2,173,330 (dymilion e njëqind e shtatëdhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë) lekë pa tvsh.

Nr.	Emërtimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlefte
1	Transport veprat pjesmarrëse, Shkoder-Tirane vajtje – ardhje.	rruge	2		
2	Transport kurator dhe juri Shkoder-Tirane vajtje -ardhje	rruge	4		
3	Transport per kuratorin Shkoder- tirane vajtje ardhje	rruge	2		
4	Transport veprash Shkoder-Tirane vajtje -ardhje	rruge	2		
5	Shpenzimettransporti per te ftuarin Tirane Shkoder vajtje –ardhje	rruge	2		
6	Rruge transport veprash dhe hamall Tirane Shkoder, vajtje- ardhje	rruge	2		
7	transport juriaTirane- Shkoder (vajtje ardhje)		2		
8	transport kurator dhe veprat pjesemarrëse Tirane- shkoder(vajtje ardhje)	rruge	2		
9	Transport për1 (nje)te ftuar, Tirane Sjkoder , vajtje – ardhje	rruge	2		
10	Transport Juria, vajtje – ardhje.Tirane	rrugë	4		
11	Transport per Banden Frymore.Vajtje-ardhje.Elbasan	rruge	1		
12	Transport per ansamblin popullor vajtje – ardhje.Prishtine	rruge	1		
13	Transport Trupa artistike vajtje – ardhje.Gjakove	rruge	1		
14	Transport trupa artistike vajtje – ardhje.Peje	rruge	1		
15	Transport Trupa artistike vajtje – ardhje.Tivat	rruge	1		

16	Transport, Ansambli vajtje – ardhje. Ulqin	rruge	1		
17	Transport Tirane – Shkoder - Tirane (20 persona)	rruge	2		
18	Transport Shkup – Shkoder - Shkup (20 persona)	rruge	1		
19	Transport Prizren – Shkoder - Prizren (20 persona)	rruge	1		
20	Transport Vlore – Shkoder - Vlore (20 persona)	rruge	1		
21	Transport Korce – Shkoder - Korce (20 persona)	rruge	1		
22	Transport Ulqin – Shkoder - Ulqin (20 persona)	rruge	1		
23	Transport trupa e aktoreve Vajtje- ardhje Korce dhe transport skenografi	rruge	1		
24	Transport per trupa e aktoreve Prishtine -Shkoder-prishtine	rruge	1		
25	Transport Trupa artistike vajtje – ardhje.- PRIZREN dhe transport skenografie	rruge	1		
26	Transport, trupa e aktoreve–Tirane - shkoder- Tirane dhe transport skenografie	rruge	4		
27	Transport për skenografinë Shkodër – Lecce- Shkodër	rrugë	1		
28	Transport për skenografinë Shkodër – Milano - Shkodër	rrugë	1		
	Total PA TVSH				
	TVSH 20%				
	Total me TVSH				

DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, RINISË, STREHIMIT, SHËNDETIT PUBLIK –
vlera e fondit limit është 42,490 (dyzet e dymijë e katërqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh.

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Cmimi për njësi	Vlera pa TVSH
1	Transport - “Mbështetja e Trupës Muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe” Nisja Shkodër – Rinas dt: 20.05.2025 në ora 06.30 e mëngjesit Kthimi Rinas - Shkodër, dt: 27.05.2025 në ora 12:00 e drekes	persona	35		
Vlera pa TVSH					
TVSH					
Totali me TVSH					

DREJTORIA E MJEDISIT DHE ENERGJISE SE RINOVUESHME – vlera e fondit limit është 96,945 (nëntëdhjetë e gjashtëmijë e nëntëqind e dyzet e pesë) lekë pa tvsh .

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Cmimi për njësi	Vlera pa TVSH
1	Projekti “Building Smart Forests” Sherbim transporti ne funksion te projektit Shkoder-Bari-Shkoder	persona	25		
Vlera pa TVSH					
TVSH					
Totali me TVSH					

V.O Ofertuesit në plotësimin e ofertës së tyre nuk duhet të kalojnë vlerën e fondit limit të secilës drejtori të përcaktuar më lart. Mosplotesimi i kesaj pike do sjell skualifikimin e ofertuesit.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit e konkretisht **925,106** (nëntëqind e njëzet e pesë mijë e njëqind e gjashtë) lekë pa tvsh.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe konkretisht **462,553** (katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre) lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës

-
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçensë transporti rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve lëshuar nga QKB kodi VII.1.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçensë transporti rrugor kombëtar të udhëtarëve lëshuar nga Bashkia ose Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë drejtuesin teknik të shoqërisë të pajisur me Certifikatë për kompetencë profesionale CKP, e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor i cili duhet të jetë i siguar dhe të figurojë në listëpagesat përkatëse E-Sig për të paktën **muajin e fundit**.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën individuale të punës, listëpagesën e muajit të fundit dhe Certifikatën për kompetencë profesionale CKP.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar 1 (një) drejtues mjeti të certifikuar për transport të udhëtarëve dhe mallrave i cili duhet të jetë i siguar dhe të figurojë në listëpagesat përkatëse E-Sig për të paktën **muajin e fundit**.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- a) lejedrejtimi të kategorisë përkatëse në varësi të llojit të automjetit që do të përdoret sipas kapacitetit
- b) Certifikatën e Aftësi Profesionale përkatëse (CAP)
- c) Kontratën individuale të punës

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3.6 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e shërbimit, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit:

1 (një) Autobuz me kapacitet akomodues prej jo më pak se 55 vendesh.

Viti i prodhimit të jetë jo më herët se viti 2005.

Të jetë i pajisur me aktivlerësimin në plotësim të kushteve për komoditetin e autobusëve në transportin e udhëtarëve brenda vendit, të lëshuar në përputhje me udhëzimin nr 7780/1, datë 24.5.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 1649, datë 16.8.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar” dhe në përputhje me nenin 9, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar.

1 (një) automjet minimalisht 5+1 për transporti udhëtarëve

1 (një) automjet transporti të mallrave jo më pak se 2.5 ton

1 (një) automjet transporti të mallrave jo më pak se 3.5 ton duhet të jetë me permasa: 6.2 m gjatësi * 2.4 m gjerësi * 2.4 m lartësi.

Per mjetet që janë në pronesi duhet të paraqitet leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracion dhe certifikata e transportit.

Kur mjetet janë me qera të paraqiten: kontrata e qerash e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, e shoqëruar me lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin, certifikatën e transportit.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin automjet.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet nevojshme _____

